

Vlerësimi për të nxënë (VpN)

Tipi i Programit: Themelor

Historiku i Programit

Vlerësimi për të nxënë, është një ndër metodat e vlerësimit të rekomanduara nga reforma arsimore. Gjatë periudhës 2012 – 2015, përmes programit BEP-USAID/KEC, është hartuar, pilotuar dhe pastaj akredituar nga KShLM një program i ngjashëm për vlerësimin për të nxënë, me të cilin pastaj janë trajnuar të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të ulta në Kosovë. Mësimdhënësit e trajnuar kanë dhënë feedback shumë të mirë lidhur me këtë program, dhe me të është dëshmuar një përmirësim i theksuar i procesit të vlerësimit të vazhdueshëm në klasë. Por, ai program ishte i përshtatur vetëm për nivelin e shkollorë fillore dhe të mesme të ult. Prandaj, mësimdhënësit e gjimnazeve kërkuan që përmes programit ASSET të hartohet edhe një program për vlerësim të vazhdueshëm për nivel të shkollës së mesme të lart.

Rrjedhimisht, në periudhën tetor 2018 – qershor 2019, programi ASSET i financuar nga USAID dhe zbatuar nga KEC, hartoi dhe pilotoi kursin me një grup trajnimi prej 25 mësimdhënësve nga 9 gjimnaze të komunave të ndryshme. Qasja e programit ASSET ka qenë që të krijohet fasilitues shkollorë, të cilët pas certifikimit kanë ofruar zhvillim profesional me bazë në shkollë për kolegët e tyre. Programi është aprovuar nga KShLM në tetor 2019 me kohëzgjatje prej dy viteve. Gjatë periudhës dy vjeçare (2019-2021) janë trajnuar dhe certifikuar me sukses mbi 300 mësimdhënës të gjimnazeve partnere të programit ASSET. Ky program për vlerësim të nxënësve, ka pas për bazë dhe reflekton dokumentet zyrtare të MASHT: *Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, Standardet e Vlerësimit, Kodin e Etikës së Vlerësimit , UA (08/2016) për vlerësimin e nxënësve dhe me aktivitetet tjera për ngritjen profesionale të mësimdhënësve.*

Me këtë dokumentacion, programi për Vlerësim për të nxënë, po dorëzohet për ri-aprovim.

Qëllimet e programit:

Qëllimi i këtij kursi është të ndihmojë mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta që të përdorin metoda efektive të vlerësimit në mënyrë që t'i ndihmojnë nxënësit e tyre për të fituar aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për karrierën e tyre, jetën dhe punën në të ardhmen. Kursi është një gërshetim i kornizës teorike për të kuptuarit e procesit të Vlerësimit formativ/Vlerësimit për të Nxënë (VpN) dhe udhëzimeve e shembujve praktikë që mbështesin proceset e mësimdhënies dhe të nxënësve. Gjatë kursit synohet të zgjerohet këndvështrimi i mësimdhënësve për vlerësimin, duke e parë atë jo si një aktivitet të izoluar që ndodhë në faza të caktuara të orës mësimore ose periudha të vitit shkollor, por si një proces të vazhdueshëm që kontribuon në zhvillimin e kompetencave të përcaktuara në Kurrikulën e Kosovës.

Pjesëmarrësit në këtë program trajnues do të pajisen me rezultatet si në vijim:

- Dallojnë vlerësimin formativ/vlerësimit për të nxënë, nga ai përmbledhës;

- Shqyrtojnë elementet, parimet dhe karakteristikat e vlerësimit për të nxënë, dhe rolin e tij në procesin e të nxënësve;
- Shqyrtojnë ciklin e VpN-së dhe strategjitë e vlerësimit formativ;
- Zhvillojnë aftësitë për zbatim të strategjive të vlerësimit formativ për aftësitë komunikuese, shqyrtimin e informacionit, planifikim strategjik dhe arsytimin kritik;
- Reflekojnë për implementimin e teknikave të vlerësimit formativ (përparësitë, vështirësitë dhe sfidat) në klasat e tyre;
- Zbatojnë strategjitë e vlerësimit formativ për vlerësimin e 'shkathtësive të buta';
- Planifikojnë mësimet modelet që përshijnë aktivitete të cilat kanë për bazë vlerësimin për të nxënë.

Përmbajtja:

Ky program ka për bazë Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, Standardet e Vlerësimit, Kodin e Etikës së Vlerësimit, UA (08/2016) për vlerësimin e nxënësve dhe me aktivitetet tjera për ngritjen profesionale të mësimitdhënësve. Në pjesën e parë të kursit, pjesëmarrësit njoftohen me llojet e vlerësimit, elementet dhe parimet e vlerësimit për të nxënë, dhe strategjitë e zbatimit të vlerësimit. Pastaj, në pjesën e dytë vazhdojnë me vlerësimin e ndërsjellë, përdorimin e informatave kthyesë, dhe njoftohen me planifikimin e mësimetve duke patur për bazë vlerësimin për të nxënë.

Ndërmjet ditës së dytë dhe të tretë, pjesëmarrësit mentorohen në klasë duke zbatuar teknikat e VpN në orën mësimore me nxënës, dhe marrin këshilla dhe sugjerime se si duhet të arrijnë të priturat e kursit.

Grupi i synuar

Te gjithë mësimitdhënësit e shkollave të mesme të larta, gjimnazeve dhe shkollave profesionale, respektivisht klasave X, XI, dhe XII. Sipas kurrikules bërthamë të këtij niveli të gjithë mësimitdhënësit do të duhej të kenë njohuri për VpN, prandaj ky program synon të përfshijë të gjithë mësimitdhënësit në mardhënie pune në arsimin e mesëm të lartë. Numri i pjesëmarrësve nuk është i kufizuar, por varësisht nga interesimi, do të synohet që të gjithë mësimitdhënësit të kalojnë nëpër këtë trajnim.

Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Pjesëmarrësit e identifikuar paraprakisht nga grupi i synuar, do të marrin pjesë në punëtori 3 ditore, secila ditë me nga 4 sesione 90 minutëshe, të moderuara nga fasilituesit profesional. Kjo përfshinë mësimitdhënie ndërvepruese, prezantime, diskutime, punë individuale, punë në dyshe, punë në grupe, etj. Pas ditës së dytë të trajnimit do të ketë hapësirë kohore prej së paku 3-4 javësh për të zbatuar VpN me nxënësit e tyre dhe gjatë kësaj periudhe do të mentorohen dhe observohen në klasë nga fasilituesit e programit, që të përkrahen në përmbushjen e kërkesave për certifikim.

Vlerësimi/Certifikimi

Në fund të këtij trajnimi pjesëmarrësit mësimitdhënës do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 24 orë të plota trajnimi (6 orë x 3 ditë= 18 orë; plus 6 orë të plota të kalkuluara për implementimin e aktiviteteve në shkollë dhe gjatë procesit të reflektimit /mentorimit).

Kriteret për certifikim janë:

- 90% pjesëmarrje në trajnim dhe në takimet reflektuese me mentor;
- Prezantimi i produktit final të realizuar me nxënësit duke dokumentuar të gjitha strategjitë dhe teknikat e realizimit të vlerësimit për të nxënë sipas udhëzimeve nga kursi.
- Prezantimi me gojë para fasilituesve dhe pjesëmarrësve të trajnimit.

Materialet e trajnimit

- Udhëzuesi për fasilitues të programit trajnues së bashku me fletat e punës;
- Sllajdet në Power Point dhe Video prezentimet;
- Vlerësimi për të nxënë – Doracak për mësimdhënës